

**Spiropali kërkon lirimin e liderëve të UÇK-së: Shqipëria, zë i fortë për të drejtën e Kosovës** FAQE 5



Na ndiqni edhe në:  
**www.epokaere.com**  
facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



## **PDK-ja: PRESIM VENDIM TË DREJTË DHE TË PANDIKUAR, BESOJMË NË PAFAJËSINË DHE LIRINË E ÇLIRIMTARËVE.** FAQE 4-5



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nëpërmjet një deklarate publike ka thënë se pret nga trupi gjyqës në Hagë të nxjerrë vendim të drejtë dhe të pandikuar politikisht për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin. Kjo

parti ka theksuar se beson në pafajësinë dhe lirinë e çlirimtarëve. "Lufta e popullit të Kosovës për liri ishte luftë e drejtë, çlirimtare dhe e domosdoshme për mbijetesë përballë një regjimi shtypës", është thënë në deklaratën e PDK-së

### **AKTUALE**



**MBAHET MBLEDHJA E PARË E BORDIT TË PAQES, TRUMPI LAVDËRON OSMANIN** F. 6

**MERZI URON KURTIN: MERRNI VENDIMET E DUHURA PËR INTEGRIMIN EUROATLANTIK TË KOSOVËS** F. 7

**AS EMËR, AS MARRËVESHJE: PSE PO VONOHEN KANDIDATURAT PËR PRESIDENT?** F. 3

### **EKONOMI**



**PRODUKTET "MADE IN KOSOVA" MARRIN IDENTITET NDËRKOMBËTAR** F. 8

**KOMISIONI PËR MBIKËQYRJEN E FINANCAVE REFUZON KËRKESËN E ZKA-SË PËR BUXHET SHITESË** F. 8

### **SPORT**



**TREPÇA FITON KUPËN E KOSOVËS PËR HERË TË PESTË RRESHT** F. 11



**'POLITICO': SHBA-ja I BËN PRESION NATO-s PËR NJË RIKONFIGURIM TË MADH, PËRFSHIRË ZVOGËLIMIN E TRUPAVE NË KFOR** F. 2

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: renova@ml.net.mk

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# “POLITICO”: SHBA-ja I BËN PRESION NATO-s PËR NJË RIKONFIGURIM TË MADH, PËRFSHIRË ZVOGËLIMIN E TRUPAVE NË KFOR

UASHINGTON, 19 SHKURT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) nën Donald Trumpin janë duke e shtyrë NATO-n të shkurtojë shumë nga aktivitetet e jashtme, duke përfshirë edhe përfundimin e një misioni kyç të aleancës në Irak, kanë thënë katër diplomatë të NATO-s për “Politico”-n.

ShBA-ja, gjithashtu, ka lobuar në muajt e fundit për ta zvogëluar operacionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë dhe për ta penguar Ukrainën dhe aleatët e Indo-Paqësorit të marrin pjesë zyrtarisht në samitin vjetor të aleancës në korrik në Ankara. Siç raporton “Politico”, kjo përpjekje pasqyron një nismë të Shtëpisë së Bardhë për ta trajtuar NATO-n si një pakt mbrojtës rreptësisht euroatlantik dhe për të zhbërë dekada zgjerimi drejt menaxhimit të krizave, partneriteteve globale dhe nismave të udhëhequra nga vlerat, të cilat prej kohësh e kanë

irrituar presidentin e ShBA-së dhe bazën e tij MAGA.

Nën nxitjen e Uashingtonit, NATO do t'i kufizonte të ashtuquajturat “aktivitete jashtë zone”, që shkojnë përtej detyrave thelbësore të aleancës për mbrojtje dhe parandalim. Kjo nismë është quajtur brenda radhëve si një “kthim në parametrat fillestarë”, thanë katër diplomatët, të cilëve u ishte garantuar anonimiteti për të folur lirshëm mbi këtë çështje të ndjeshme të brendshme. Përpjekja mund të sjellë një reduktim të shpejtë të aktivitetëve të NATO-s në ish-zonat e luftës, si dhe përjashtimin e kryeqyteteve, përfshirë Kievin dhe Kanberren, nga diskutimet zyrtare këtë verë. Shtëpia e Bardhë ka refuzuar t'i komentojë publikisht mbi programet e partneritetit dhe operacionet globale të NATO-s kur është kontaktuar nga “Politico”.



Tërheqja nga Kosova

ShBA-ja ka sinjalizuar se do ta zvogëlojë misionin në Kosovë, KFOR, të udhëhequr nga NATO, sipas katër diplomatëve, që është edhe më shqetësuese për aleatët evropianë, edhe nëse diskutimet për këtë mbeten në një fazë shumë të hershme. Misioni ndërkombëtar paqeruajtës i autorizuar nga OKB-ja, i cili nisi në vitin 1999 pas luftërave jugosllave,

aktualisht përfshin rreth 4 500 trupa.

Engjëllushe Morina, një bashkëpunëtorë e lartë e politikës në Këshillin Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë, ka thënë se misioni mbetet “i domosdoshëm” për sigurinë rajonale. “Nëse NATO tërhiqet, kjo mund t'i inkurajojë separatistët serbë në veri të Kosovës”, ka thënë ajo, duke shtuar se kjo krijon një efekt kopjimi midis serbëve etnikë në rajonin e Republika Srpska të

Bosnjës.

“Jemi mjaft të shqetësuar për përpjekjet për ta shkurtuar misionin”, ka thënë një diplomat i pestë i lartë i NATO-s, pasi “gjërat në Ballkanin Perëndimor mund të përshkallëzohen shpejt”.

I kontaktuar nga “Politico”, një zyrtar i NATO-s që fliste në emër të organizatës ka thënë se “nuk ka një afat kohor të lidhur me misionin e NATO-s në Irak... ose me KFOR-in”, duke shtuar: “Këto misione bazohen në nevojë, i nënshtrohen rishikimit periodik dhe përshtaten me evoluimin e rrethanave”.

Për momentin nuk është marrë asnjë vendim për përfundimin e asnjërës prej operacioneve. Të 32 aleatët duhet ta miratojnë fillimin dhe përfundimin e misioneve, një proces që zakonisht përfshin manovra politike dhe fushata presioni nga disa aleatë, jo vetëm nga ShBA-ja.

## ISH-PRESIDENTI I KORESË SË JUGUT, YOON, DËNOHET ME BURGIM TË PËRJETSHËM

SEUL, 19 SHKURT - Një gjykatë në Korenë e Jugut e ka dënuar ish-presidentin Yoon Suk Yeol, me burgim të përjetshëm, pasi e ka gjetur fajtor për udhëheqjen e një kryengritjeje në vitin 2024. Yoon papritur kishte shpallur gjendje lufte gjatë një adresimi televiziv dhjetorin e vitit 2024, duke thënë se masat drastike ishin të nevojshme për t'i çrrënjësuar “forcat antishtetërore” në Asamblenë Kombëtare të Koresë së Jugut.

Konservatori i linjës së ashpër, Yoon, 65 vjeç, më vonë është ndjekur penalisht, duke u arrestuar dhe akuzuar për krime të ndryshme, përfshirë për kryengritje dhe pengim të drejtësisë.



Gjykatësi kryesor Ji Gwi-yeon ka thënë se Yoon kishte dërguar trupa në ndërtesën e Asamblesë në përpjekje për t'i heshtur kundërshtarët politikë të cilët kishin penguar përpjekjet e tij për

të qeverisur. “Gjykata gjen se qëllimi ishte që të paralizohet Asambleja për një periudhë të konsiderueshme. Shpallja e gjendjes së luftës rezultoi me pasoja të mëdha sociale, dhe

është e vështirë që të gjendet ndonjë tregues se i pandehuri ka shprehur keqardhje për këtë gjë”, ka thënë Ji Ji Gwi-yeon në Gjykatën e Qarkut Qendror të Seulit, duke shqiptuar dënimin. “Ne e dënojmë Yoonin me burgim të përjetshëm”, ka thënë ai.

Ish-ministri i Mbrojtjes, Kim Yong-hyun, është dënuar me 30 vjet burgim për rolin e tij në këtë krizë.

Prokurorët kanë kërkuar dënimin më të ashpër për akuzën për kryengritje ndaj Yoonit dhe në seancat dëgjimore në janar kërkuar që ai të dënohej me vdekje. Koreja e Jugut ka një moratorium jozyrtar për dënimin kapital, të burgosurit e fundit ishin ekzekutuar më 1997,

prandaj një dënim me vdekje, efektivisht e lë Yoonin përjetë prapa grilave. Mijëra mbështetës janë mbledhur jashtë ndërtesës së gjykatës para vendimit, duke mbajtur slogane të tilla si “Yoon Madhështor Sërish” ose “Hidhni poshtë akuzat kundër presidentit Yoon”.

Turmat kanë brohoritur kur vetura e burgut e ka transportuar ish-presidentin për në gjykatë. Pranë gjykatës janë dislokuar forca të sigurisë për të shtypur çdo trazirë.

Përveç këtij dënimi, Yoon veçse ishte dënuar me pesë vjet burgim për akuza të tjera, ndërkaq zyrtarë të tjerë të lartë janë dënuar po ashtu me dënime të ashpra me burg.

## Dosja Epstein, arrestohet vëllai i Mbretit Charles

LONDËR, 19 SHKURT - Policia ka arrestuar vëllanë e Mbretit të Mbretërisë së Bashkuar, Andrew Mountbatten-Windsor. “BBC”-ja ka mësuar se Andrew Mountbatten-Windsor është arrestuar nën dyshimin për keqpërdorim të funksionit publik.

Andrew, i cili ka mbushur 66 vjeç, sot është ndaluar në Sandringham Estate në Norfolk, ka njoftuar Policia e Thames

Valley. Ai është nën shqyrtim të ri pasi pjesa e fundit e materialeve të publikuara nga të ashtuquajturat dosje Epstein ka hedhur dritë të mëtejshme mbi marrëdhënien e tij me pedofilin e ndjerë.

Policia ka thënë se nuk po e zbulojnë identitetin sipas udhëzimeve kombëtare. “Është e rëndësishme që të mbrojmë integritetin dhe objektivitetin e hetimit tonë ndërsa punojmë

me partnerët tanë për të hetuar këtë vepër të supozuar penale. Ne e kuptojmë interesin e rëndësishëm publik në këtë rast dhe do të ofrojmë përditësime në kohën e duhur”, ka thënë policia britanike.

Sir Keir Starmer është bërë figura e fundit e profilit të lartë që ka ushtruar më shumë presion mbi Andrew të enjten, ndërsa u është bashkuar thirrjeve që ai të dëshmonte

zyrtarisht për lidhjet e tij.

Duke folur për “BBC Breakfast”, kryeministri ka këmbëngulur se “askush nuk është mbi ligjin”. “Kushdo që ka ndonjë informacion duhet të dëshmojë. Pra, qoftë Andrew apo dikush tjetër, kushdo që ka informacion përkatës, duhet të paraqitet para organit përkatës, në këtë rast të veçantë po flasim për Epstein, por ka shumë raste të tjera”, ka thënë Starmeri.



# AS EMËR, AS MARRËVESHJE: PSE PO VONOHEN KANDIDATURAT PËR PRESIDENT?

PRISHTINË, 19 SHKURT - 4 marsi po afrohet. Kjo është data e fundit kur Kuvendi i Kosovës duhet të votojë për figurën që do ta mbajë pozitën e presidentit të shtetit për një mandat pesëvjeçar. Të gjitha partitë politike përmendin nevojën për një figurë konsensuale, dhe flasin për bashkëpunim dhe marrëveshje. Megjithatë, emra konkretë nuk ka. Çfarë po presin partitë?

“Figurë konsensuale” - këto mund të jenë fjalët që i bëjnë bashkë të gjitha partitë politike në Kosovë kur bëhet fjalë se kush duhet ta mbajë pozitën e presidentit të shtetit në pesë vjetet e ardhshëm. Por, këtu përfundon gjithçka.

Partitë nuk po dalin hapur me idetë e tyre se kush është personi i denjë për atë pozitë, dhe po presin ftesën e njëra-tjetrës për t’i nisur diskutimet. Donika Emini, nga Grupi Këshillues për Politikën e Ballkanit në Evropë, thotë për “Radion Evropa e Lirë (REL)” se partitë opozitare i sheh në pozitë shumë të pafavorshme, sepse pavarësisht kuorumit që kërkohet për zgjedhjen e presidentit, Lëvizja Vetëvendosje (LV) e kryeministrit Albin Kurti e ka shumicën e konsiderueshme - 57 vota në Kuvend. Megjithatë, ajo beson që procesi do të zhvillohet relativisht qetë, “sepse askush nuk dëshiron zgjedhje të reja, as Vetëvendosje dhe as partitë opozitare”.

## Çfarë thonë partitë?

Shefja e grupit parlamentar e LV-së, Arbërie Nagavci, ka thënë për “REL”-in se për partinë që përfaqëson ajo, prioritet këto ditë kanë pasur konstituimi i Kuvendit dhe formimi i Qeverisë, ndërsa tani në radhë është miratimi i



Buxhetit të shtetit për vitin 2026. Sipas saj, nga java e ardhshme nisin diskutimet “për proceset e reja”.

Nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), deputeti Artan Behrami ka thënë se në momentin që pranojnë ftesë nga LV-ja apo nga partitë tjera, janë të gatshëm të diskutojnë për emrin që “personifikon unitetin e qytetarëve”. “Qëndrimi i partisë është që ne duhet t’i nënshtrohemi një dialogu politik me partitë tjera politike, dhe nga ai diskutim, nga këto kompromise dhe dialog, do të dalë edhe presidenti ose presidentja”, ka thënë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Me gjithë përpjekjet, “REL”-i nuk arriti të siguronte nga një qëndrim prej deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në këtë drejtim. Kreu aktual i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë ditë më

parë se u është ofruar partive të mëdha opozitare shqiptare për bashkëpunim në këtë çështje, mirëpo e ka parë që nuk kanë vullnet. “Nëse opozita do të mund ta prezantonte një kandidat të vetin, ose mua, ose cilindo kryetar partie, një figurë, dhe ta mblidhte votën, do ta kishim një balancim të pushtetit. Unë nuk jam kandidat, sepse nuk kam bazë kandiduese, duhen 30 nënshkrime”, ka thënë ai.

Dhe, ashtu është. Duhet të sigurohen të paktën 30 firma të deputetëve që një emër të kandidohet për president, ndërsa duhen siguruar dy të tretat e votave në Kuvendin me 120 vende për ta fituar atë pozitë. Kuorumi arrihet me 80 deputetë. Nëse në dy rundet e para të votimit një kandidat nuk i siguron 80 vota, atëherë në votimin e tretë mjafton t’i ketë 61. Bekim Jashari, nga familja e heroit të Kosovës, Adem Jashari, është përmendur në të kaluarën si

kandidat potencial për president, mirëpo ky propozim nuk është jetësuar kurrë.

## Dilemat për Osmanin

Presidentja aktuale, Osmani, është kritikuar nga partitë opozitare se ka qenë e afërt me LV-në. Ato kanë thënë se ajo nuk përfaqëson figurë unifikuese, pa përmendur diçka konkrete. Në anën tjetër, Osmani ka thënë se i duhet një mandat i dytë për t’i vazhduar “punët e mira” që ka thënë se i ka nisur. Emrin e saj për mandatin e parë e pati çuar përpara LV-ja. Këtë herë, partia në pushtet nuk po e përmend asnjë emër. “Unë jam e bindur që, në bazë të mandateve që i kemi, në bazë të përgjegjësve ndaj shtetit dhe institucioneve, ne do të bëjmë gjithçka që është në dorën tonë dhe që mundemi, që të ofrojmë alternativën më të mirë dhe të mbështesim atë alternativë”, ka thënë Nagavci për “REL”-in.

Emini beson se arsyeja e

mosdaljes me një emër ka të bëjë me kalkulimet strategjike të LV-së. “Duke e zvarritur procesin, dhe duke mos dalë me emër konkret, LV-ja po blen kohë. Sa më shumë afrohet afati, aq më pak hapësirë ka opozita për t’u organizuar dhe për të dalë me një alternativë të unifikuar”, ka thënë ajo.

## A duhet t’i jepet Osmanit një mandat i dytë?

Deputeti i PDK-së, Artan Behrami, ka thënë se Osmani nuk e meriton një mandat të dytë. “Personalisht, mendoj që zonja Osmani më shumë mund t’i kontribuojë opozitës si antipod i qeverisë Kurti, sesa si presidente e Republikës së Kosovës”, ka thënë ai. Emini ka thënë se performanca e Osmanit duhet të shihet nga dy dimensione. Në rrafshin e brendshëm, ajo ka përmendur kufizimet që ia përcaktan Kushtetuta e Kosovës këtij roli, si dhe zhgënjimin që mund të ketë ekzistuar për qasjen e saj në kohë krizash politike, ndërsa në nivelin ndërkombëtar ka vlerësuar se Osmani ka qenë dukshëm më e suksesshme. “Pra, duke qëndruar vetëm te figura e saj, pa e krahasuar me kandidatë të tjerë, që për momentin nuk ekzistojnë, mund të thuhet se ajo duhet marrë merita për rolin aktiv në nivel ndërkombëtar. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme për faktin që Kosova sot më shumë se kurrë ka nevojë për një diplomaci të sofistikuar për të naviguar një rend botëror të vështirë”, ka thënë Emini. Pavarësisht rolit ceremonial presidencial, mospërmbushja e afateve i kushton shtetit. Nëse Kosova nuk e ka emrin e ri për pozitën e presidentit deri më 4 mars, atëherë duhet t’i organizojë zgjedhjet e reja parlamentare brenda 45 ditësh.

## Mbahet mbledhja e parë e Bordit të Paqes, Trumpi lavdëron Osmanin

UASHINGTON, 19 SHKURT - Të enjten në Uashington është mbajtur mbledhja e parë e Bordit të Paqes, nismë e presidentit amerikan Donald Trump, për t’u dhënë fund konflikteve në botë. Në këtë mbledhje kanë marrë pjesë edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Me këtë rast presidenti Trump ka falënderuar Vjosa

Osmanin për pjesëmarrjen në Bordin e Paqes. Gjatë prezantimit ai ka thënë se Osmani po bën punë të shkëlqyera. “Presidentja Osmani nga Kosova, faleminderit shumë, po bëni punë të shkëlqyera!”, ka thënë Trumpi. Presidenti amerikan është shprehur i nderuar edhe me praninë e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama.

Më tutje, Trumpi e ka cilësuar Bordin e Paqes një nga projektet më të rëndësishme që ka marrë pjesë ndonjëherë. Ai ka deklaruar se gjatë këtij viti ShBA-ja ka ndaluar tetë luftëra dhe është pranë përfundimit të një të nëntë, duke nënvizuar se konfliktet mbeten të paparashikueshme. “Dua të shpëtoj njerëz”, ka thënë Trumpi.



# ANDONI: JEMI VONUAR PËR MBROJTJEN E LIDERËVE TË UÇK-së

Publicisti nga Tirana, Ben Andoni, ka thënë se Kosova dhe Shqipëria janë vonuar për t'i mbrojtur në mënyrë të duhur Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin, të cilët më 18 shkurt kanë thënë fjalët e tyre përfundimtare në procesin gjyqësor në Hagë. Andoni ka thënë se faktori shqiptar nuk është bashkuar për një narracion të përbashkët dhe, sipas tij, shqiptarët i kanë braktisur liderët e UÇK-së. “Më është dukur se faktori shqiptar s’ka qenë në sinkron që të punonte prej muajsh për një narracion që edhe luftën ta ngrinte, por edhe t’i shfaqësonte sa më shumë katër liderët e UÇK-së”, ka thënë ai

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Publicisti Ben Andoni ka thënë se Kosova dhe Shqipëria janë vonuar për t'i mbrojtur në mënyrë të duhur katër liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai ka thënë se faktori shqiptar nuk është bashkuar për një narracion të përbashkët dhe, sipas tij, shqiptarët i kanë braktisur ata.

Ai ka thënë se nuk i beson pretendimit të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, se presidentja e Kosovës është kërcënuar për dy vjet nga Prokuroria e Specializuar në Hagë për shkak se s'i ka lënë të kryejnë kontrolle në zyrën e Presidentit. Sipas tij, Vjosa Osmani “po kërkon një lloj protagonizmi të tepruar në këto situata”. Andoni dyshon se ajo mund të rizgjidhet në pozitën e presidentes pasi, siç ka thënë, e ka humbur disi këtë mundësi me kalimin e kohës.

*Si e keni parë procesin gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Gjykatën Speciale në Hagë?*

**Andoni:** Ashtu si mendohej të ishte. Personalisht, procesi më është dukur i zvargur dhe disi konfuz. Tashmë jemi shumë të vonuar sa i përket një strategjie të duhur mbrojtëse. Dukej se Tribunali i kishte gati akuzat dhe procesi thjesht është zhvilluar për t'i justifikuar akuzat. Më është dukur se faktori shqiptar s'ka qenë në sinkron që të punonte prej muajsh për një narracion që edhe luftën ta ngrinte, por edhe t'i shfaqësonte sa më shumë, katër liderët e UÇK-së. Strategjia e mbrojtjes së tyre duhej të përgatitej nga një grup juristësh dhe historianësh të mirë prej kohësh, bashkë me një fushatë të zgjedhur mediatike. Por, ashtu si janë zhvilluar punët në Kosovë dhe mënyra sesi i kanë akuzuar liderët dhe vetë shqiptarët po mendoj se ne i braktisëm ata. Shpresoj dhe mendoj logjikisht që dënimi i tyre do të jetë në rastin më të keq shumë më pak vite sesa kërkoi Prokuroria.

*Kryeministri Rama tha të hënën në Prishtinë se ky proces është “një katastrofë” dhe i ndikuar nga “forca që duan t'i barazojnë dy forca që nuk barazohen dot”. Çfarë dëmi politik do t'i bënte Kosovës një dënim me burgim për katër ish-krerët e UÇK-së?*

**Andoni:** Kam përshtypjen që z. Rama dhe të tjerët, në këto orë



para vendimit, duhet të heshtin dhe nëse do të duan të flasin të jenë sa më “fair” me Dhomat e Specializuara. Kjo sepse çdo fjalë e tepërt mund të shkaktojë probleme tek verdikti final i Trupit Gjyqësor. Dhe, gjuha e përdorur prej z. Rama disa herë ka qenë e tepërt. Ka mjaftuar mbrojtja dhe deklarata që bënë të katër liderët për të treguar sublimitetin e kauzës së tyre dhe besimin real se janë të pafajshëm. Sidomos, në rastin e z. Thaçi, që është një nga njerëzit që e ka mundësuar këtë Gjykatë dhe mënyra sesi u drejtua e tregoi shumë të matur dhe të vendosur për fatin e tij.

Sa për argumentin e barazimit me Serbinë, ky element nuk qëndron. Janë mbi 90 serbë që kanë dalë para Gjykatës së Krimeve të Luftërave për Ish-Jugosllavinë. Paçka dënimeve të pamjaftueshme të një pjese prej tyre, që nuk e ka justifikuar veprimtarinë e tyre, personalisht kam perceptimin se kanë marrë përbuzjen e të gjithë botës së qytetëruar me atë që bënë në Slloveni, Kroaci dhe kulmuan në Bosnjë me masakrat e paimagjinueshme për civilizimin në shekullin XX. Nuk ka asnjë krahasim me Kosovën që është mbrojtur dhe për më tepër është përzënë gati e gjithë popullsia nga Kosova. Nga ana politike e brendshme, dënimi i tyre, do ‘qetësonte’ një pjesë të politikanëve në Kosovë, sepse do të largoheshin dy

protagonistë si Thaçi dhe Veseli që u bënin hije, por edhe do vendoste konjunktura të tjera tek PDK-ja për të ardhmen. Sa i përket aspektit të jashtëm, do i jepte pak më shumë oksigjen politikës së jashtme serbe, lidhur me pengesat e vazhdueshme që i bënë Kosovës dhe përpjekjes së saj për të retushuar imazhin e agresorit. Por, lehtësinë më të madhe do e kishte Brukseli se do gjente një ekuilibër për politikën e saj fluide dhe plot gabime në rajon, të cilën do ta mbajë në këtë rast me një status quo jo normale.

*Rama foli për një kërcënim ndaj Osmanit nga Prokuroria në Hagë, për shkak se, siç tha, s'i ka lejuar të kontrollojnë në zyrën e Presidentit. Disa e panë si ndihmë për synimin e saj për ta marrë një mandat të dytë. Juve si ju është dukur?*

**Andoni:** Nuk besoj të ketë pasur kërcënim për zonjën Osmani, ashtu siç shtrohet për median ky lajm. Prokuroria kërkon dokumente, po nuk mund të kontrollojë një zyrë presidenti, kur mendon se Dhomat e Specializuara dhe vetë Prokuroria e Hagës janë nën tagrin e ligjeve të Kosovës. Por, protagonizmi i saj i kohëve të fundit është i lodhshëm dhe paçka qëndrimeve të saj të fundit në mbrojtje të liderëve në Hagë nuk duhet harruar retorika e saj për ato personazhe. Nëse mund të

kishte kërcënime mund të kishte Kurti, kurse zonja Osmani po kërkon një lloj protagonizmi të tepruar në këto situata, ku Kosova është ende në zgrip dhe ende pa gjetur ekuilibrin për zgjedhjen e presidentit të ardhshëm. Është ende një ngërç që mund të shkaktojë zgjedhje të tjera. Ka kohë që z. Rama po e mbështet dhe duket si një lloj qasje tjetër institucionale e Ramës ndaj Kosovës përmes marrëdhënies me të. Komunikimi i mirë dhe pragmatizmi i bashkon shumë kohët e fundit Ramën me Osmanin, kohë kur të dy kanë shumë probleme në vendet respektive.

*A shihni shanse që Osmani të rizgjidhet presidente edhe për një mandat?*

**Andoni:** Personalisht e dyshoj rizgjedhjen, sepse me kalimin e kohës ka humbur shumë si figurë unifikuese dhe pozicionin e besueshmërisë mbi partitë, ndërsa “Guxo”, formacioni i saj, nuk është më faktor si më parë në Kosovë. Në shumë raste, ajo nuk ka qëndruar dot mbi palët, kurse shemria me gratë e tjera të qeverisë Kurti e bëjnë atë jo një figurë aq të dashur te LV, ashtu si qëndrimi që ka mbajtur ndaj partive të tjera, ku LDK-ja do e ketë të vështirë ta pranojë dhe një mandat tjetër, gruan, që gati e shpërbeu këtë formacion me ikjen e saj.

*Rama u prit me ceremoni shtetërore nga kryeministri Kurti në Prishtinë. Çfarë tregon kjo, sipas jush?*

**Andoni:** Po mendoj se është normale dhe e mirë dhe e arsyeshme, sepse zakonisht vizitat e para të krerëve të shteteve në vende të ndryshme por që kanë kombet e ngjashme e kanë të arsyeshme këtë lloj protokolli. Ashtu, si me gjasë, Kurti vizitën e parë zyrtare do ta bëjë në Tiranë. I vetmi handicap është se u bë një ditë para festimeve të pavarësisë dhe pothuajse nuk dihej fare në Tiranë. Duket si një takim i sajuar. Megjithatë, personalisht më erdhi mirë që Rama shkoi në Kosovë dhe do të doja të ishte shumë më i pranishëm atje dhe madje të rigjallërojë me Kurtin idetë e mbledhjeve të përbashkëta të rregullta, kuptohet pasi të kenë bërë një inventar për dhjetërat e marrëveshjeve mes dy vendeve tona.

*Rama dhe Osmani janë në Uashington për takimin inaugurues të Bordit të Paqes. Ju keni folur për interesa të caktuara lidhur me këtë. Keni thënë se Shqipërisë mund t'i kërkohet të strehojë palestinezë. Po Kosovës?*

**Andoni:** Besoj që të dy vendeve tona, më shumë nga një logjikë e arsyeshme, do t'u kërkohet të kontribuojnë në një kohë të caktuar. Kuptohet nëse Bordi i Paqes do të bëhet ndonjëherë me fuqi ekzekutive. Duke ditur se buxhetet e dy vendeve tona janë shumë modeste, duke parë predispozitën që kemi për çdo gjë që bën ShBA-ja, arsyeja më shtyt në besoj se ky lidhet me kontributin tonë, përpos pjesëmarrjes me ndonjë trupë ushtarake ose të ndonjë lloji tjetër, nëse kërkohet. Por deri tani, “Bordi i Paqes” është ende i paqartësuar, ndaj neve na mbetet të presim, sidomos pasojat e këtij vendimi pjesëmarrjeje që për hir të së vërtetës, në këtë moment historik, na ka veçuar disi me Evropën. Duke ditur se i vetmi kontribut yni është strehimi dhe kjo po ndodh në të dy vendet tona dhe me bisedat e fundit zyrtare për projektet e burgjeve me Danimarkën dhe Belgjikën, besoj se Shqipëria pas muxhahedinëve dhe afganëve nuk është çudi të presë dhe palestinezët, diçka që e kemi bërë dikur në socializëm, duke stërvitur grupet e tyre të rezistencës.

## Spiropali kërkon lirimin e liderëve të UÇK-së: Shqipëria, zë i fortë për të drejtën e Kosovës

TIRANË, 19 SHKURT - Ministria e Punëve të Jashtme, Elisa Spiropali, ka theksuar se Shqipëria do ta mbrojë drejtësinë e luftës së drejtë të Kosovës dhe të drejtën e krerëve të UÇK-së në Hagë. Nga Kuvendi i Shqipërisë, ajo ka kërkuar drejtësi për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe

Jakup Krasniqin. “Marrëdhënia me Kosovën nuk është një raport i zakonshëm i politikës sonë të jashtme, por përgjegjësi historike dhe kombëtare. Shqipëria do të mbetet një zë i fortë për të drejtën e Kosovës, për integrimin e saj ndërkombëtar dhe dinjitetin e shtetit të saj. Sepse stabiliteti

i rajonit kalon përmes një Kosove të fortë, të njohur dhe të integruar në strukturat euroatlantike. Në këtë kuadër, proceset në Hagë kanë një rëndësi të veçantë. Shqipëria është dhe do të mbetet e angazhuar ndaj drejtësisë ndërkombëtare, por drejtësia ndërkombëtare nuk është një koncept abstrakt, ajo matet

me standardet e barazisë, me koherencën e saj dhe aftësinë që të mos kthehet në instrument leximi të njëanshëm të historisë. Lufta e Kosovës nuk ishte një konflikt për pushtet, por luftë për mbijetesë dhe liri. Ky është një fakt i dokumentuar ndërkombëtarisht”, ka thënë Spiropali.



## PDK-JA: PRESIM VENDIM TË DREJTË DHE TË PANDIKUAR, BESOJMË NË PAFAJËSINË DHE LIRINË E ÇLIRIMTARËVE

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nëpërmjet një deklarate publike ka thënë se pret nga trupi gjykues në Hagë të nxjerrë vendim të drejtë dhe të pandikuar politikisht për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin. Kjo parti ka theksuar se beson në pafajësinë dhe lirinë e çlirimtarëve. “Lufta e popullit të Kosovës për liri ishte luftë e drejtë, çlirimtare dhe e domosdoshme për mbijetesë përballë një regjimi shtypës”, është thënë në deklaratën e PDK-së



Thaçi, Veseli, Krasniqi e Selimi, secili veç e veç, kanë ngulur këmbë në fjalët e tyre përmbyllëse, se ndihen tërësisht të pafajshëm dhe kanë mbrojtur luftën e UÇK-së, duke thënë se ajo ishte e drejtë për çlirimin e një populli që po përballlej me një luftë agresore. Ata kanë thënë se nuk kanë kryer asnjë krim dhe se prokuroria nuk ka mundur t'i arsyetojë akuzat, siç kanë thënë, të pabazuara kundër tyre.

Pas përfundimit të deklaratave të tyre, kryegjykatësi Charles Smith III e ka shpallur të mbyllur çështjen gjyqësore. Smith ka bërë me dije se do të jetë në kontakt me palët në muajt në vijim lidhur me datën e shpalljes dhe rishikimit të aktgjykimit në këtë rast. Trupi gjykues ka tre muaj kohë që të marrë një vendim për çështjen, ose të kërkojë zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit. Seanca e fundit është mbajtur vetëm një ditë pasi mijëra qytetarë, në 18-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, janë mbledhur në Prishtinë në mbështetje të katërshe të UÇK-së, duke kërkuar gjykim të drejtë. Zyra e Prokurorit të Specializuar ka kërkuar 45 vjet burgim për secilin.

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 19 SHKURT - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nëpërmjet një deklarate për medie ka thënë se pret nga Gjykata Speciale të nxjerrë vendim “të drejtë, të paanshëm dhe të bazuar ekskluzivisht në fakte dhe prova, larg çdo narrative apo perceptimi politik”, për liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), gjykimi i të cilëve është përmbjllur të mërkurën në Hagë.

Katërshtja e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë deklaruar plotësisht të pafajshëm në raport me akuzat e ZPS-së.

“Në këtë fazë vendimtare Partia Demokratike e Kosovës ka shprehur pritjen dhe kërkesën

e saj që vendimi të jetë i drejtë, i paanshëm dhe i bazuar ekskluzivisht në fakte dhe prova, larg çdo narrative apo perceptimi politik. Lufta e popullit të Kosovës për liri ishte luftë e drejtë, çlirimtare dhe e domosdoshme për mbijetesë përballë një regjimi shtypës. Kjo është një e vërtetë historike e njohur nga qytetarët tanë dhe e konfirmuar nga rrjedha e zhvillimeve ndërkombëtare që çuan në ndërhyrjen e NATO-s dhe në shpalljen e pavarësisë së Kosovës”, është thënë në deklaratën e PDK-së.

PDK-ja ka thënë se pret që vendimi do ta konfirmojë lirimin e plotë nga të gjitha pikat e aktakuzës. “Ne besojmë në pafajësinë e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit dhe presim që, pa zvarritje dhe mbi bazën ekskluzive të fakteve e provave,

të merret një vendim i drejtë dhe i paanshëm, i cili do ta konfirmojë lirimin e plotë nga të gjitha pikat e aktakuzës. Partia Demokratike e Kosovës rithekson solidaritetin me familjet e ish-krerëve të UÇK-së, falënderon të gjithë qytetarët për mbështetjen e madhe të dëshmuar përmes marshimeve dhe protestave, si dhe shpreh mirënjohje për profesionalizmin dhe hapësirën e ofruar nga mediet gjatë gjithë kësaj periudhe”, është thënë në deklaratë.

Çështja gjyqësore kundër liderëve e të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë ka përfunduar pas gati tri vjetëve. Të mërkurën e 18

shkurtit, avokatët e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Kadri Veseli e Jakup Krasniqi si dhe ish-deputetit Rexhep Selimi, kanë dhënë argumentet e tyre të fundit mbrojtëse. Ata kanë përsëritur argumentet e tyre se Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) nuk ka dëshmi për akuzat e ngritura dhe nuk ka arritur ta provojë fajësinë e tyre, prandaj kanë kërkuar aktgjykim shfajësues. Më pas, mbrojtja e viktimave ka thënë para trupit gjykues se ajo nuk e ka obligim t'i vërtetojë akuzat ndaj të akuzuarve. Në fund të ditës ishte radha e liderëve të UÇK-së për t'u deklaruar përfundimisht rreth akuzave me të cilat ngarkohen.

## “The Independent” për Thaçin: Burrështetasi që kërkoj lirim nga Haga

PRISHTINË, 19 SHKURT - Gazeta britanike “The Independent” ka shkruar për fjalët e fundit të ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në gjyqin ndaj ish-katërshe të UÇK-së në Hagë. Artikulli i tyre fillon duke treguar se ish-presidenti e paraqiti veten të mërkurën si një burrështeti dhe paqebërës, ndërsa u kërkoj gjyqtarëve ndërkombëtarë ta lironin nga ato që ai i quajti akuza të pabaza, duke përfshirë vrasje, tortura dhe persekutim që datojnë që nga lufta e kombit të tij për pavarësi.

“Gjatë gjithë jetës sime kam

qëndruar me popullin e Kosovës duke mbrojtur lirinë, jetën dhe dinjitetin. Gjithmonë jam udhëhequr nga ideatet perëndimore të demokracisë, barazisë dhe drejtësisë”, u ka thënë Hashim Thaçi gjyqtarëve në fund të gjyqit të tij gati trevjeçar në Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Më tutje, në artikull është thënë se mbështetësit në galerinë publike të gjykatës në fillim të fjalimit të Thaçit u shtynë pas murit prej xhami që i ndante nga salla e gjyqit për ta përshëndetur ish-



presidentin përpara se të qortohej nga rojet e sigurisë. Një burrë, është thënë në

artikull, shihej duke fshirë lotët derisa Thaçi fliste. Prokurorët kanë kërkuar

dënim maksimal prej 45 vjetësh burgim për Thaçin dhe të pandehurit e tjerë, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin.

Thaçi përballlet gjithashtu me një gjyq të veçantë për akuzat e frikësimit të dëshmitarëve që do të fillojë më vonë këtë muaj. Në deklaratën e tij përfundimtare para gjykatës, Thaçi, i cili gjithmonë ka këmbëngulur se është i pafajshëm, tha se “i vetmi vendim i drejtë do të ishte liri im i plotë nga akuzat”. “Gjatë gjithë asaj kohe e vetmja fuqi që kisha ishte fuqia e zërit tim”, ka thënë Thaçi.

# 18 VJET BURGIM PËR SHQIPTARIN QË VRAU ARGJENTINASEN NË FUSHË-KOSOVË

PRISHTINË, 19 SHKURT - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar Endrit Nikën me 18 vjet burgim për vrasjen e partneres, shtetase argjentinase, në Fushë-Kosovë, më 2023. Aktgjykimi është shpallur të enjten nga trupi gjykues. Të pranishëm në seancë ishte i pandehuri me avokatin e tij dhe mbrojtja e palës së dëmtuar. Në maj të vitit 2025, Nika ishte deklaruar i pafajshëm për akuzën për vrasje.

**Rrjeti i Grave të Kosovës:**  
Dënimi nuk është  
proporcional me peshën  
e krimit

Pas shqiptimit të aktgjykimit, Rrjeti i Grave të Kosovës, ka thënë se dënimi prej 18 vjetësh burgim “nuk është proporcional me peshën e krimit” dhe seriozitetin e rethanave. Përmes një reagimi në rrjetet sociale, ky rrjet ka thënë se kjo vrasje është me motiv gjinor - femicid, duke theksuar se vrasja e grave për shkak të gjinisë së tyre është shkelja më e rëndë e të drejtës

për jetë “dhe kërkon ndëshkim maksimal”.

“Dënime të tilla rrezikojnë të normalizojnë dhunën ndaj grave dhe të dërgojnë mesazh se jeta e grave vlen më pak. Kërkojmë që gjykatat ta njohin qartë motivin gjinor dhe të aplikojnë standardet më të larta të ndëshkimit. Drejtësia duhet të jetë reale, proporcionale dhe e pamëshirshme ndaj femicidit”, është thënë në reagim.

Rrjeti i Grave të Kosovës ndihmon viktimat e dhunës me bazë gjinore, duke ofruar këshillim dhe ndihmë juridike falas.

**Çfarë thuhet në  
aktakuzën ndaj Nikës?**

Aktakuza Endrit Nikës ishte ngritur në shkurt të vitit 2025. Sipas prokurorisë, më 1 gusht të vitit 2023, në një hotel në Fushë-Kosovë, pas një mosmarrëveshjeje paraprake me tashmë të ndjerën, ai e kishte goditur atë dhe kishte tentuar ta shkelte me veturë në parkingun e hotelit. Me të hyrë në dhomën e hotelit,



sipas aktakuzës, Nika me dashje që ta privojë nga jeta viktimën M.K-U., kishte vazhduar përleshjen dhe goditjet ndaj saj duke e dërguar në qoshen e dhomës, ku ajo nuk kishte pasur mundësi të largohej. Aktakuza thotë se më pas e kishte shtyrë

viktimën, e kishte nxjerrë në kornizën e dritares duke e hedhur nga dritarja e dhomës së hotelit që gjendej në kat të gjashtë. Për shkak të rrëzimit nga lartësia, viktimë nuk u mbijetoi plagëve. Në Kosovë nga viti 2010 deri më tani janë vrarë rreth 60 gra.

Organizatrat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në disa raste, kanë fajësuar autoritetet për dështim në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga dhuna. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

## KËRKOHET FORCIMI I SIGURISË HEKURUDHORE NË KOSOVË

PRISHTINË, 19 SHKURT - Dhoma Britanike e Tregtisë në Kosovë ka bërë thirrje që urgjentisht të forcohet siguria hekurudhore në Kosovë. Në reagimin e kësaj ode është theksuar se siguria hekurudhore në Kosovë kërkon veprim të koordinuar dhe të qëndrueshëm kombëtar pas aksidenteve të vazhdueshme në kryqëzime dhe mungesave të vazhdueshme në infrastrukturë krahasuar me standardet evropiane të sigurisë në zhvillim. Ndërsa statistikën e konsoliduar zyrtare për aksidentet hekurudhore më të fundit ende nuk janë publikuar, raportimet e fundit lokale tregojnë për incidente të shumta në kryqëzime, përfshirë përplasje fatale. “Në prill 2025, një përplasje treni me një automjet në Jagodë, Klinë, rezultoi me një fatalitet dhe tre të lënduar. Një aksident i fundit në vitin 2026 pranë Kazermës Ushtarake “Adam Jashari” afër Prishtinës, ku treni goditi një automjet, përfundoi me fatalitetin e një anëtarit të Forcave të Sigurisë



së Kosovës. Këto incidente theksojnë reziqet e vazhdueshme në kryqëzimet hekurudhore dhe nënvizojnë nevojën urgjente për përmirësime strukturore”, është thënë në reagimin e Dhomës Britanike të Tregtisë në Kosovë.

Vlerësimet rajonale të mëparshme, përfshirë raportimet e Komunitetit të Transportit (Transport Community), tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e aksidenteve hekurudhore në Kosovë ndodhin në kryqëzime. Nga rreth 267 kryqëzime

hekurudhore në të gjithë vendin, shumica mbeten të mbrojtura në mënyrë pasive, duke munguar barriera automatike, drita pulsuese ose sisteme paralajmëruese zanore. Kjo përbindje mbetet dukshëm më e lartë se në shumë shtete anëtare të

Bashkimit Evropian, ku një pjesë më e madhe e kryqëzimeve kanë sisteme aktive mbrojtje. Më tutje, Dhoma Britanike e Tregtisë në Kosovë ka bërë thirrje për veprim të koordinuar kombëtar. “Përmirësimi i sigurisë hekurudhore nuk është vetëm një çështje infrastrukturore - është në thelb një imperativ i sigurisë publike. Ulja e fataliteteve dhe lëndimeve të rënda kërkon angazhim të qëndrueshëm politik, investime të shënjestruara, forcim institucional dhe miratimin e praktikave më të mira evropiane të provuara. Duke modernizuar kalimet në nivel, duke përmirësuar sistemet e sinjalizimit, duke forcuar kornizat rregullatore dhe duke investuar në sistemet e kompetencës profesionale, Kosova mund të ulë ndjeshëm shkallën e aksidenteve, të rrisë besimin e publikut dhe të afrohet progresivisht me standardet evropiane të sigurisë hekurudhore”, është thënë në reagimin e Dhomës Britanike të Tregtisë në Kosovë.

## Arrestohen tre persona për vjedhje të rëndë në Mitrovicë

MITROVICË, 19 SHKURT - Policia e Kosovës ka arrestuar tre persona të dyshuar për veprën penale “vjedhje e rëndë” në Mitrovicë, pas raportimit të dy rasteve të thyerjes së lokaleve në lokacione të ndryshme të qytetit. Sipas njoftimit të

policisë, rastet janë raportuar në orët e mëngjesit të 19 shkurtit në stacionin policor - Mitrovicë Jug. Njësitë kompetente policore kanë reaguar menjëherë dhe, pas disa orësh veprime operative dhe hetimore, kanë arritur të identifikojnë tre të

dyshuar, njëri prej të cilëve i mitur. Gjatë kontrollit tek të dyshuarit janë gjetur dhe sekuestruar gjësendet e vjedhura nga lokalitetet e thyera. Të dyshuarit janë arrestuar dhe shoqëruar në stacionin policor, ku janë intervistuar dhe janë

ndërmarrë procedurat e nevojshme hetimore. Me vendim të prokurorit të rastit, ndaj tyre është iniciuar rasti penal për veprën “vjedhje e rëndë”, ndërsa të dyshuarve u është caktuar masa e ndalimit policor prej 48 orësh.



## Merzi uron Kurtin: Merrni vendimet e duhura për integrimin euroatlantik të Kosovës

PRISHTINË, 19 SHKURT - Kancelari i Gjermanisë, Friedrich Merz, ka uruar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për rizgjedhjen në krye të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Përmes letrës, Merzi ka thënë se mezi pret të punojë me Kurtin, për t'i thelluar më tej marrëdhëniet e ngushta midis dy shteteve. "Ju përgëzoj ngrohtësisht për rizgjedhjen tuaj. Pres me padurim të punoj me ju për të thelluar më tej marrëdhëniet e ngushta dhe miqësore midis

vendeve tona", ka thënë Merzi, sipas njoftimit të lëshuar nga qeveria gjermane. Ndër të tjera, kancelari gjerman ka kërkuar nga kryeministri Kurti t'i marrë vendimet e duhura dhe të nevojshme për integritetin e vazhdueshëm euroatlantik. Po ashtu, ai ka përmendur edhe dialogun me Serbinë. "Ju dhe qeveria juaj përballeni me detyra sfiduese. Jam i bindur se, me përvojën tuaj, do t'i merrni vendimet e duhura dhe të nevojshme për

integrimit e vazhdueshëm euroatlantik të Kosovës. Kjo përfshin përparim të mëtejshëm në dialogun e normalizimit me Serbinë, të ndërmjetësuar nga BE-ja. Ju lutem të jeni të sigurt se Kosova ka një partner të fortë dhe të besueshëm në Gjermani në këto përpjekje. Ju uroj fat të mbarë dhe sukses në mandatin tuaj të vazhdueshëm", thuhet në telegramin e urimit të kancelarit të Gjermanisë, ka thënë Merzi.



## IKD-ja KËRKON PËRMES REZOLUTËS TË OBLIGOHEM MF-ja PËR PËRFITIMIN E PENSIONEVE TË DYFISHTA

PRISHTINË, 19 SHKURT - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka dorëzuar të enjten kërkesën që ia ka drejtuar kryetares së Kuvendit, Albulena Haxhiu, edhe shëfave të grupeve parlamentare, për iniciimin e debatit parlamentar lidhur me moszbatimin e legjislacionit pozitiv dhe realizimin e të drejtës në pensionin e moshës, krahas pensionit dhe përfitimeve të përcaktuara me Ligjin për Kategoritë e Dala nga Lufta.

Hulumtuesi në IKD, Naim Jakaj, ka thënë se Kuvendi duhet të nxjerrë një rezolutë ku e obligon Ministrinë e Financave (MF) për përfitimin e pensioneve të dyfishta. "Ne kërkojmë që të zhvillohet një debat parlamentar brenda dy-tre javësh ose një muaji, në mënyrë që Ministria e Financave dhe Ministria e Punës të nxjerrin një rezolutë ku Kuvendi tregon arsyet pse nuk është nxjerrë ky akt ligjor që e realizon këtë të drejtë për përfitim të pensionit të dyfishtë, për pasojat juridike, sociale dhe financiare të këtij mosveprimi dhe për nevojën për veprim urgjent të Ministrisë së Financave. Presim shumë shpejt nga shëfat e grupeve parlamentare, por presim edhe nga kryetarja e Kuvendit që ta ushtrojë autoritetin dhe të thërrasë një



seancë", tha ai.

Ndërsa hulumtuesja tjetër në IKD, Arrita Rezniciq, ka thënë se legjislacioni në fuqi u lejon qytetarëve të këtyre kategorive të drejtën e përfitimit të pensioneve të dyfishta. Madje ajo ka thënë se Qendra për Ndihmë Juridike Falas e IKD-së ka paraqitur rreth 700 padi për realizimin e të drejtës në

pension të dyfishtë. Sipas saj, aktgjykimet e pranuar deri tani të gjitha janë aprovuese. "Legjislacioni në fuqi u lejon qytetarëve të këtyre kategorive të drejtën për përfitimin e dy pensioneve. Kjo e drejtë është e konfirmuar dhe konsoliduar përmes praktikës gjyqësore deri në nivelin e Gjykatës Supreme. Të gjithë personat që

arrijnë moshën e pensionimit nuk mund dhe nuk duhet të detyrohen të zgjedhin mes njërit apo tjetrit pension. Atyre u takojnë të dyja pensionet dhe, rrjedhimisht, nuk mund t'u mohohet e drejta në të dy pensionet. Kjo do të thotë se të gjithë ata që arrijnë moshën e pensionimit e kanë të drejtën edhe si kategori e dalë nga

lufta", ka thënë ajo.

Ajo ka theksuar se mbetet e paqartë pse, përkundër qartësisë së ligjit, praktikës gjyqësore të konsoliduar dhe vetë ekzekutimit të vendimeve nga ana e Ministrisë, po vazhdohet refuzimi i kërkesave të reja të qytetarëve që deri më tani nuk kanë aplikuar për njohjen e kësaj të drejte.

## Zëvendëskryeministri Ahmeti flet në NCAFP për politikën e jashtme të Kosovës dhe marrëdhëniet me ShBA-në

NJU-JORK, 19 SHKURT - Zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Republikës së Kosovës, Kreshnik Ahmeti, i ftuar nga Komiteti Kombëtar i Politikës së Jashtme Amerikane (NCAFP), ka folur në tryezën e rrumbullakët për

politikën e jashtme të Kosovës dhe marrëdhëniet me ShBA-në. Në diskutimin e moderuar nga ambasadorja Susan Elliott, presidente dhe CEO e NCAFP-it, zëvendësministri Ahmeti u është përgjigjur shumë pyetjeve nga diplomatë, ekspertë amerikanë

dhe studentë të marrëdhënieve ndërkombëtare për Kosovën dhe pozitën e saj ndërkombëtare. Në këtë tryezë ka marrë pjesë edhe ambasadori Blerim Reka, shef i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork.



# PRODUKTET ‘MADE IN KOSOVA’ MARRIN IDENTITET NDËRKOMBËTAR

Prishtinë, 19 shkurt - Produktet “Made in Kosova” janë eksportuar prej vitesh me barkode të huaja, shpesh duke u regjistruar si produkte nga Shqipëria ose vende të tjera, për shkak të mungesës së një barkodi shtetëror të njohur ndërkombëtarisht.

Kosova ka siguruar këtë muaj barkodin ndërkombëtar 381, duke u dhënë produkteve vendore një identitet të verifikueshëm globalisht. Për më shumë se dy dekada, produktet e prodhuara në Kosovë kanë udhëtuar drejt tregjeve ndërkombëtare me një identitet të huaj. Në raftet e dyqaneve evropiane dhe globale, vajrat, pijet dhe prodhime të tjera “Made in Kosova” shpesh janë regjistruar si me origjinë nga Shqipëria apo shtete të tjera jo për shkak të vendit të prodhimit, por për shkak të mungesës së një barkodi shtetëror të njohur ndërkombëtarisht.

Kjo ka qenë një pasojë më pak e dukshme e statusit të Kosovës si shteti më i ri në Evropë, por që vazhdon të përballet me njohje të pjesshme ndërkombëtare dhe integrim të paplotë në shumë mekanizma globalë.

Situata, megjithatë, po ndryshon. Kosova ka siguruar këtë muaj barkodin ndërkombëtar 381, duke u dhënë për herë të parë produkteve vendore një identitet të verifikueshëm globalisht. Për një vend që synon t’i rrisë eksportet dhe të integrohet më thellë në tregun evropian dhe global, ky është një hap i rëndësishëm drejt konsolidimit të sovranitetit ekonomik dhe pranisë së tij në zinxhirët ndërkombëtarë të furnizimit, vlerësojnë ekspertët.

Barkodi, përndryshe, është një numër unik identifikues që përmban informacion për kompaninë dhe vendin e origjinës së produktit dhe mund të skanohet kudo në botë, përmes pajisjeve optike apo aplikacioneve telefonike.

## Identiteti i huazuar për produktet vendore

Kompania “Fluidi” nga Gjilani, e cila prodhon vaj ushqimor dhe pije freskuese, është ndër prodhuesit kosovarë që për vite me radhë është detyruar të sigurojë barkode jashtë vendit, për të eksportuar jashtë. “Në raftet e marketeve të shteteve evropiane dhe globale, produktet e prodhuara në Kosovë kanë figuruar me origjinë nga Shqipëria ose shtete të tjera”, ka thënë pronari Berat Mustafa për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas tij, rreth 30 për qind e prodhimit të kësaj kompanie eksportohet në vendet e rajonit, Evropë dhe Afrikë. Dhe, deri më tani, për secilin produkt ka qenë e nevojshme të sigurohej barkod jashtë Kosovës. “Unë i kam blerë barkodet në Shqipëri, pasi atje e kam të regjistruar kompaninë dhe ka qenë më e lehtë. Shumë biznese të Kosovës kanë vepruar njësoj, ose kanë përdorur barkode të siguruar nga vetë kompanitë blerëse në vendet ku eksportojnë”, ka shpjeguar Mustafa. Sipas tij, kjo situatë ka krijuar një paradoks: megjithëse praktikë e lejueshme, produktet janë prodhuar në Kosovë, por nuk kanë qenë zyrtarisht të identifikueshme si të tilla në sistemin global të tregtisë, duke kufizuar dukshmërinë e tyre dhe mundësinë për të ndërtuar një reputacion ndërkombëtar. Mustafa ka treguar se vetëm në Shqipëri ka paguar mbi 200 euro në vit për barkodet e dhjetë prodhimeve të tij. “Nuk është shumë e lartë kostoja financiare, por barkodi 381 promovon drejtpërdrejt produktet tona dhe shtetin e Kosovës”, ka thënë Mustafa.

## Nga zgjidhja emergjente në njohje ndërkombëtare

Deri më tani në tregun e Kosovës është përdorur barkodi 390 - i cili është vendosur në



vitin 2003 nga Oda Ekonomike e Kosovës, në përputhje me kompetencat e saj ligjore për administrimin e identifikimit të produkteve - si një zgjidhje emergjente për skanimin e tyre në tregun vendor. Megjithatë, ky kod nuk ishte pjesë e sistemit global të identifikimit të produkteve.

Në praktikë, kjo nënkuptonte se produktet e Kosovës mund të qarkullonin në tregun vendor, por për eksport kërkonin integrim në sisteme të huaja identifikimi.

Situata ndryshoi këtë muaj, kur Kosova, përmes Odës Ekonomike të Kosovës, nisi për herë të parë lëshimin e barkodeve me prefiksin 381 - gjashtë muaj pas anëtarësimit në rrjetin global GS1. GS1 është një organizatë ndërkombëtare jofitimprurëse me seli në Bruksel, e cila zhvillon dhe administron standardet globale për identifikimin e produkteve, shërbimeve dhe zinxhirëve të furnizimit në të gjithë botën. Ky sistem përdoret nga miliona kompani dhe është thelbësor për funksionimin e tregtisë moderne, logistikës dhe shitjes me pakicë.

## Fundi i një praktike që zbehte identitetin “Made in Kosova”

Kryetari i Shoqatës së Prodhuesve të Kosovës, Kushtrim Ajvazi, ka thënë se praktika e huazimit të barkodeve jo vetëm që ka rritur kostot administrative dhe

financiare për prodhuesit, por ka ndikuar edhe në zbehjen e identitetit të produkteve të Kosovës në tregjet ndërkombëtare. Për një ekonomi të vogël dhe në zhvillim si Kosova, ndërtimi i një identiteti të njohur eksportues është kritik për tërheqjen e partnerëve tregtarë dhe investimeve të huaja. “GS1 në Kosovë është identifikimi i produkteve ‘Made in Kosova’ në tregun global”, ka thënë Ajvazi për “Radion Evropa e Lirë”. Ai ka thënë se sistemi i ri rrit edhe transparencën për konsumatorët. “Përmes barkodit, konsumatorët mund të verifikojnë origjinën e produktit, prodhuesin dhe përmbajtjen - çka rrit besueshmërinë dhe sigurinë në treg”, ka thënë ai.

## Barkodi nuk mjafton për t’i zgjidhur sfidat e eksportit

Megjithëse e konsiderojnë si një hap të rëndësishëm, përfaqësuesit e biznesit kanë paralajmëruar se barkodi ndërkombëtar nuk është zgjidhje për të gjitha sfidat me të cilat përballen prodhuesit e Kosovës. Kosova mbetet një ekonomi e vogël prej rreth 1.5 milion banorësh, me bazë të kufizuar prodhimi dhe varësi të lartë nga importi. Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Biznesit, ka thënë se sfidat kryesore për prodhuesit vendorë mbeten strukturore. Sipas tij, politikat e

papërshtatshme fiskale dhe rritja e kostove operative - veçanërisht e çmimit të energjisë elektrike pas daljes së bizneseve në tregun e hapur vitin e kaluar - kanë ulur konkurrueshmërinë e tyre. Ai ka thënë se Kosova ka potencial eksportues, por kërkohet mbështetje më e madhe institucionale dhe një qasje më e koordinuar për depërtimin në tregjet e huaja.

“Ne mbesim vend që dëshiron eksportin, por në praktikë favorizojmë konsumimin e produkteve të huaja. Jemi bërë besnikë ndaj produkteve të importuara”, ka thënë Shahini.

## Deficiti tregtar mbetet sfida kryesore

Pabarazia ndërmjet importit dhe eksportit mbetet një nga treguesit më të qartë të sfidave ekonomike. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, gjatë vitit të kaluar vendi ka importuar mallra në vlerë mbi shtatë miliardë eurosh - nisur nga ushqimi deri te materiali ndërtimor e tekstili.

Në të njëjtën periudhë kohore, eksportet kanë arritur në rreth 942 milionë euro, ose vetëm 2.6 milionë euro në ditë. Në këtë kontekst, kanë thënë ekspertët, barkodi 381 përfaqëson më shumë sesa një ndryshim teknik. Ai është një hap drejt identitetit të produkteve të Kosovës në tregun global, por suksesi i tij do të varet nga aftësia e vendit për t’i mbështetur prodhuesit dhe për ta kthyer këtë identitet në një avantazh real ekonomik.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili ka nisur mandatin e ri javën e kaluar, ka premtuar një miliard euro në formë garancish e kredish për prodhuesit. Berat Mustafa pret ta shpenzojë stokun e vjetër dhe produktet e reja t’i regjistrojë me barkodin 381, i bindur se ky kod do t’i plasojë produktet e Kosovës në tregjet ndërkombëtare me identitet të qartë dhe të pakundërshtueshëm: “Made in Kosova”.

## Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave refuzon kërkesën e ZKA-së për buxhet shtesë

PRISHTINË, 19 SHKURT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka kërkuar mbi 654 mijë euro buxhet shtesë nga shuma e përgjithshme e paraparë në Projektligjin për Buxhetin e vitit 2026, pasi nga kjo zyrë kanë thënë se duhet të rekrutojnë staf shtesë, po ashtu u duhet buxhet edhe për mallra, shërbime dhe kategori të tjera. “Këto 10 pozita të reja kemi kërkuar t’i mbulojmë për auditimin e fondeve të BE-së”, ka sqaruar drejtori i

përgjithshëm i ZKA-së, Safet Berisha.

Por kërkesa e ZKA-së nuk është përkrahur në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave, përkatësisht nga deputetët e shumicës parlamentare. Kundër kësaj kërkesë janë deklaruar pesë deputetë, tre për dhe një ka abstenuar.

Anëtarët e komisionit nga radhët e LV-së kanë kërkuar që në këtë fazë të mos bëhen ndryshime në buxhet. Sipas



tyre, kërkesat e institucioneve publike mund të përfshihen në buxhet kur të bëhet rishikimi i

tij muajin e ardhshëm. Mirëpo këtë qëndrim të pushtetit e kanë kundërshtuar

deputetët e opozitës. “Kërkoj me kujdes t’i shqyrtojmë kërkesat e tyre. Këto janë në përputhje me Ligjin e Pagave e rregullore të tjera. Nëse këtyre ju ndalim këtë mundësi, në fund të vitit ne kemi me qenë përgjegjës për mosrealizimin e planit të ZKA-së. Unë besoj që sot ose duhet ta miratojmë kërkesën e tyre ose mazhoranca të marrë zotim, që këto të shkojnë përpara”, ka deklaruar deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti.

# “POPULIZMI”: DIKUR E DINIM ÇFARË DO TË THOSHTË, TANI FJALA PËRCËKTUESE E EPOKËS SONË E KA HUMBUR KUPTIMIN

Nga: Oliver EAGLETON /  
*The Guardian*

“Populizmi” mund të ketë qenë fjala përcaktuese e dekadës së kaluar: një stenografi për partitë rebeluese që dolën në pah në vitet 2010, duke sfiduar dominimin e qendrës liberale. Por, sapo u bë temë kryesore për të diskutuar si të majtën ekstreme ashtu edhe të djathtën ekstreme, komentatorët nisën të vinin në dyshim vlefshmërinë e tij: duke u shqetësuar se ishte tepër i paqartë, ose tepër përçmues, apo se i ushqente forcat të cilave u referohej.

Tani, me fatet e dy poleve politike që po marrin drejtime të ndryshme - e djathta duke fituar terren në gjithë Perëndimin, ndërsa një pjesë e madhe e së majtës përpiket të rimëkëmbet pas humbjeve të njëpasnjëshme - ideja se kjo fjalë mund të përfshijë akterë kaq të ndryshëm duket edhe më pak e besueshme. Për një shpjegim të qartë të këtyre forcave, mund të na duhet ta zhvendosim vëmendjen diku tjetër: të gjejmë terma që mund të shpjegojnë pabarazinë e tyre në balancën e pushtetit, në mënyrë që të gjejmë edhe zgjidhjen e duhur.

Është domethënëse vështirësia për të ndarë natyrën reale të populizmit nga diskursi i tensionuar që e rrethon, sepse ndër të paktat pohime të sigurt që mund të bëjmë për fenomenin populist është se ai ushtron një theks të jashtëzakonshëm mbi gjuhën. Slogane të pashlyeshme, liderë elokuentë, një adresim i drejtpërdrejtë ndaj “popullit”: këto ishin elementet e përbashkëta në një gamë përndryshe të larmishme projektsh elektorale - që morën hov pas recesionit të madh të viteve 2007-2009 - duke hedhur poshtë frazat e zbrazëta për “unitet” dhe “konsensus” në favor të dallimit të fortë semantik midis “nesh” dhe “atyre”.

Me gjithë problemet e etiketës populiste, ajo të paktën arrinte ta kapte këtë modalitet thellësisht retorik të politikës, e cila zuri rrënjë në një kohë kur pjesa më e madhe e artikullimit politik kufizohej në fushën e fjalëve dhe jo të veprave: shpërthime në Twitter (tani X) dhe debate rreth tryezës së darkës, në vend të grevave dhe përplasjeve në rrugë. Nëse populizmi ishte deridiku shënjuar bosh, ai pasqyronte një kulturë të zbrazur - ku rënia e partive masive, sindikatave dhe shoqatave të tjera vullnetare kishte lënë pak kanale për aktivizëm. Erozioni i këtyre strukturave i detyroi politikanët “autsajderë” të gjenin mjete të tjera për të avancuar. Në vend që



të ndërtonin baza të tilla popullore, ata u mbështetën te frazat e shkurtra për të monopolizuar ekonominë e vëmendjes dhe për të mobilizuar votuesit e zhgënjyer.

Por, teksa “populizmi” ishte një përmbledhje e dobishme e këtyre strategjive elektorale, ai ishte më pak i aftë të përcaktonte se çfarë synonin të bënin këta liderë sapo të hynin në qeveri. Në ShBA, për shembull, Bernie Sanders e kishte të qartë se synimi i tij si president do të ishte ta përdorte shtetin për të ringjallur lëvizjen punëtore dhe për të kufizuar pushtetin e sektorit të korporatave. Grupi përreth Donald Trumpit gjithashtu ka një plan të menduar për ta riorientuar politikën shtetërore, duke përqendruar autoritetin në ekzekutiv dhe duke e përdorur atë kundër grupeve të ndara në raca. Edhe pse populizmi mund të ketë qenë mjeti, qëllimet ishin më të gjera. Duke i parë Sandersin dhe Trumpin vetëm përmes metodave të fushatës së tyre, komentatorët shmangën një analizë më të thellë të projekteve të tyre qeverisëse: socialdemokraci radikale apo neo-nacionalizëm i linjës së repte.

Gjatë dekadës së fundit, njëri prej këtyre projekteve ka vazhduar të grumbullojë pushtet - jo vetëm në ShBA, por edhe në Itali, Finlandë, Sllovaki, Hungari, Britani, Francë dhe gjetkë - ndërsa tjetri kryesisht është marginalizuar. Doli se kur e majta dhe e djathta përballeshin në terrenin e diskursit, me politikën shpesh të reduktuar në një seri prezantimesh promovuese, shanset ishin në

favor të së djathtës, jo më pak sepse një media partiake ishte e gatshme të përhapte mesazhin e saj. Si përfundim, socialdemokracia e Sandersit mbetet thjesht një ide, ndërsa neo-nacionalizmi trumpian po bëhet gjithnjë e më shumë realitet.

Në dritën e këtij zhvillimi, kufijtë e paradigmes populiste janë bërë edhe më të qartë. Tipari kryesor i politikës sonë nuk janë më kandidatët më të dobët që përdorin këtë mjet për të kapur shtetin; është e majta ajo që përpiket të rindëtojë veten pas dështimit të kësaj përpjekjeje, ndërsa një pjesë e madhe e së djathtës konsolidon suksesin e saj. Socialistët kanë kuptuar se populizmi, si praktikë politike, nuk është mjaftueshëm i fortë për t'i rezistuar një sulmi nga institucionet më të fuqishme të shoqërisë: ministritë shtetërore, partitë e qendrës, gazetatat tradicionale, lobet e biznesit, gjykatat.


Reaksionarët, ndërkohë, kanë mësuar se mund t'i fitojnë zgjedhjet mbi një platformë populiste, por ende po përcaktojnë cilën marrëdhënieje ta kultivojnë me këto institucione. Post-populistët, në të dyja anët, përcaktohen nga mënyra se si i qasen këtyre kështjellave të elitës: jo vetëm në retorikë, por edhe në veprime. Këtu opsionet janë të dyfishta. Ose mund të bëjnë kompromis me rrezikun e asimilimit, ose të ndërmarrin një sfidë të drejtpërdrejtë me rrezikun e mposhtjes. Në Spanjë, liderja aktuale e së majtës, Yolanda Díaz, ka ndjekur rrugën e parë: duke u përpjekur të arrijë marrëveshje me qendrën e majtë dhe bizneset e mëdha, por duke

kuptuar vazhdimisht kufijtë e ndikimit të saj. Në Francë, përkundrazi, Jean-Luc Mélenchon ka ruajtur pavarësinë politike të partisë së tij dhe ka refuzuar lëshimet që do ta rrezikonin atë, por kjo deri më tani e ka lënë shumë të izoluar për të tejkaluar kundërshtarët.

Një ndarje e ngjashme shihet edhe në skajin tjetër të spektrit. Përderisa liderët si Giorgia Meloni në Itali kanë kërkuar afrimin me bllokun tradicional të pushtetit, duke u tërhequr nga politikat më të rrezikshme, të tjerët, përfshirë Trumpin, kanë ndjekur një strategji më luftarake: duke sulmuar burokracinë shtetërore, duke injoruar gjyqësorin dhe shpesh duke anashkaluar kërkesat e biznesit. Si e majta ashtu edhe e djathta duhet të zgjedhin midis negociimit me elitat tradicionale ose përpjekjes për t'i shtypur ato. Megjithatë, shanset janë thellësisht të pabarabarta. Ashtu siç e djathta e ka më të lehtë t'i fitojë zgjedhjet përmes mesazheve populiste, ajo është gjithashtu më e aftë ta menaxhojë këtë zgjedhje midis pajtimit dhe ballafaqimit. Arsyeja është e qartë. Socialistët kanë një program që do ta përmbyste rendin aktual shoqëror, ndërsa neo-nacionalistët synojnë të forcojnë hierarkitë e tij. Njëri grup dëshiron ta shkatërrojë konsensusin neoliberal; tjetri ta thellojë pabarazinë e tij të klasës, racës dhe gjinisë. Institucionet që mbikëqyrin këtë sistem, për rrjedhojë, do t'i rezistojnë më fort të majtës sesa së djathtës. Ato mund të bllokojnë disa nga veprimet më destabilizuese të kësaj të fundit - si përpjekjet për

të vjedhur zgjedhjet - por, e kuptojnë se nuk ka një mospërputhje thelbësore interesash. Prandaj, pavarësisht nëse neo-nacionalistët janë më pajtues apo më agresivë, gradualë apo përshpejtues, ata mund t'i përdorin këto qendra pushteti për ta çuar përpara projektin e tyre: një luks që progresistëve u mungon.

“Populizmi” nuk mund t'i ndriçojë këto prirje - jo vetëm sepse termi është tepër i gjerë ose i ngarkuar, por sepse ai ishte më i përshtatshëm për një periudhë specifike kur sfiduesit përpiqeshin të thyenin dominimin elektoral të qendrës përmes lojërave gjuhësore: shumica kundër pakicës, të brendshmit kundër të jashtëmëve. Edhe pse këto diskurse nuk janë zhdukur, rëndësia e tyre është zvogëluar në një botë ku ky dominim tashmë është thyer dhe ku përplasia mes populizmit të majtë dhe atij të djathtë është vendosur në favor të së djathtës. Një qasje më e mirë ndaj momentit tonë aktual do të ishte të studiojmë se si të dyja forcat po përpiqen, prej pikënisjeve shumë të ndryshme, të lëvizin brenda peizazhit institucional të neoliberalizmit: e majta duket e penguar qoftë kur zgjedh kompromisin, qoftë kur zgjedh ballafaqimin, ndërsa e djathta është në gjendje të ecën përpara me secilën prej tyre. Do të jetë jashtëzakonisht e vështirë ta përmbysim këtë situatë. Duhet të fillojmë duke kuptuar thelbin e politikës bashkëkohore, jo thjesht stilin e saj. /Telegrafi/



## Muriqi në superformë, por golat e tij nuk mjaftojnë për Mallorcan

**MALLORCA, 19 SHKURT** - Vedat Muriqi po kalon sezonin më produktiv në karrierën e tij me fanellën e RCD Mallorca. Sulmuesi i Kosovës ka realizuar 16 gola në këtë edicion, një rekord personal për të në elitën e futbollit spanjoll. Megjithatë, sipas “Diario de Mallorca”,

kontributi i tij në tabela nuk është reflektuar sa duhet në pikë. Mediumi spanjoll ka theksuar se 16 golat e Muriqit i kanë sjellë skuadrës vetëm shtatë pikë, një statistikë që ngre pikëpyetje mbi efikasitetin kolektiv të ekipit. Fundjavën e kaluar “Pirati” ka realizuar një gol spektakolar

me kokë ndaj Betisit, por sërish Mallorca ka mbetur pa fitore. Ishte ndeshja e pestë radhazi në të cilën Muriqi ka shënuar dhe skuadra nuk arrin t’i marrë tri pikët, ndërsa në këtë seri përfshihet edhe barazimi ndaj Osasunës. Pavarësisht kësaj, Muriqi renditet golashënuesi i dytë

më i mirë në La Liga, vetëm pas yllit të Real Madridit, Kylian Mbappe. Forma e tij është e padiskutueshme, por Mallorca duket se duhet ta gjejë mënyrën për ta shndërruar më mirë produktivitetin e sulmuesit të Kosovës në rezultate konkrete.



## TREPÇA FITON KUPËN E KOSOVËS PËR HERË TË PESTË RRESHT

**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Trepça ka triumfuar në finalen e Kupës me rezultat të thellë 91:72, duke konfirmuar dominimin në basketbollin e Kosovës dhe duke e ngritur nëntë herë këtë trofe. Finalja e zhvilluar në Rahovec ka nisur e baraspeshuar. Bashkimi e ka mbyllur çerekun e parë në epërsi 19:16, ndërsa mitrovicasit kanë reaguuar në të dytin me 27:22 për të shkuar në pushim me avantazh minimal 43:41. Ndeshja është vendosur në çerekun e tretë. Skuadra e

drejtuar nga Adis Beqiragiq ka dominuar plotësisht këtë periudhë me rezultat 22:12, duke krijuar diferencë të sigurt (65:53) para 10 minutave të fundit. Çereku i katërt ishte formalitet, me “Xehetarët” që ruajtën epërsinë rreth 20 pikë deri në fund për fitore bindëse. Mustapha Amzil ishte më i dalluari te Trepça me 22 pikë e 12 kërcime, ndërsa Akili Vining shtoi 20 pikë dhe gjashtë asistime. Ja’Cori Payne ka kontribuar me 13 pikë e 10 asistime. Te



Bashkimi është veçuar Lejson Zeqiri me 19 pikë, ndërsa Ike Nwamu ka realizuar 16 pikë dhe shtatë kërcime. Për Trepçën ky është trofeu i 20 në basketbollin e Kosovës, ndërsa Bashkimi mbetet me një Kupë të fituar në vitin 2001 dhe humb finalen për herë të nëntë. Mitrovicasit tashmë konsiderohen favoritë të mëdhenj edhe në garën për titullin kampion. Palestra në Rahovec ishte e mbushur me tifozë të të dyja skuadrave, pa incidente të regjistruara.

## XHIROJA E 21-TË NDEZ SUPERLIGËN, DUELE DIREKTE DHE PIKË JETIKE NË LOJË



**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Fundjava dhe fillimi i javës së ardhshme do të sjellin pesë përballje interesante në Albi Mall Superligën e Kosovës, ku çdo pikë mund të peshojë rëndë si në garën për titull ashtu edhe në luftën për mbijetesë. Xhiroja e 21-të hapet të shtunën në Malishevë, ku Malisheva pret Dukagjinin në “Liman Gegaj”. Një duel i rëndësishëm për të dy skuadrat, që synojnë t’i konsolidojnë pozitat në mesin e tabelës dhe ta

shmangin presionin e zonës së rrezikshme. Të dielën vëmendja zhvendoset në Ferizaj, ku Ferizaj përballlet me Ballkanin. Kampionët në fuqi kërkojnë vazhdimësinë e rezultateve pozitive, ndërsa vendasit synojnë befasinë përballë një prej skuadrave më konstante të sezonit. Po të dielën zhvillohet edhe derbi më tërheqës i xhiros, ai në mes të Gjilanit dhe Prishtinës. Një përballje tradicionale, me histori, emocione dhe rëndësi të madhe për renditjen, ku çdo

gabim mund të kushtojë shtrenjtë. Në Podujevë, Llapi pret Dritën në një tjetër duel me peshë të madhe. Drita synon të mbetet në garë për kreun, ndërsa Llapi kërkon pikë të arta për stabilitet dhe ngjitje në tabelë. Xhiroja mbyllet të hënën në Malishevë, ku Drenica do të përballlet me Prishtinën e Re. Një ndeshje direkte për mbijetesë, ku tensioni dhe rëndësia e pikëve pritet të jenë maksimale. Të gjitha ndeshjet janë paraparë të fillojnë nga ora 13:00.

## Mbappe mban primatin e golashënuesve në Ligën e Kampionëve

Madrid, 19 shkurt - Në Ligën e Kampionëve, francezi Kylian Mbappe, sulmues i Real Madridit, vazhdon ta kryesojë tabelën e golashënuesve me 13 gola në 8 ndeshje këtë sezon, edhe pse në ndeshjen e

fundit nuk ka shënuar në fitore ndaj Benficas me rezultatin 1-0. Mbappe, gjithashtu, ka vendosur një rekord në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve falë golave të tij të shumtë në këtë fazë.

### RENDITJA AKTUALE E GOLASHËNUESVE NË LIGËN E KAMPIONËVE:

1. Kylian Mbappe - 13 gola (Real Madrid)
2. Anthony Gordon - 10 gola (Newcastle United), përfshirë një performancë me 4 gola në një ndeshje ndaj Qarabag në fazën e “play-off”-it.
3. Harry Kane - 8 gola (Bayern München)
4. Erling Haaland - 7 gola (Manchester City)
5. Gabriel Martinelli - 6 gola (Arsenal)
6. Victor Osimhen - 6 gola (Galatasaray)



**NJOETIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Özcan Investment” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b UNIK: 812337592 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Özcan Investment” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812337592 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Özcan Investment” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812337592 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Aktes Group” SH.P.K. pronar Abubekir Kavurmaci me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 812254564 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Aktas Group” D.O.O. Abubekir Kavurmaci Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812254564 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Aktes Group” L.L.C. with owner Abubekir Kavurmaci with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812254564 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

# TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ardian Shabani shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III te shkollës se mesme të lartë “Dr, Xheladin Deda”.
- Asllan Babaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III dhe diplomën e shkollës së mesme të larte të gjimnazi “Frang Bardhi”.
- Doni ES Sh.p.k. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues 811273507.
- Florentina Trepça shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë “Dr, Xheladin Deda”.
- Sami Mustafa shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fehmi Rama” ish shkolla fillore “Emin Duraku” Likoc Skenderaj.
- Hysen Ferizi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Azem Bejta” Prekaz i Eperm Skenderaj.
- Rustem Tahiri shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Trepça” Stanterg.
- Drita Zabeli shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Malush Ahmeti” ish shkolla “Muharrem Bekteshi” Rezalle Skenderaj.
- Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.
- Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.
- Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.
- Zejnije Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Titulli:** Zyrtar/e për mbështetje të operimeve në Sistemet e Pagesave  
**Grada:** P06  
**Kohëzgjatja e punësimit:** me afat të pacaktuar  
**Departamenti:** Departamenti i Sistemeve të Pagesave-DSP  
**Divizioni:** Divizioni i Operimit të Sistemeve-DOSP  
**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit të Operimit të Sistemeve

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësie:

- Kryen detyrat e parapara në kuadër të procedurave të punëve operacionale, në Sistemin e Pagesave-KIPS, si dhe sistemet tjera, ne kuadër të fushëveprimit të Departamentit;
- Koordinon aktivitetet me Departamentin e Teknologjisë Informative në BQK, në raste të ngritjes së problemeve të natyrës teknike/operacionale apo edhe zhvillimeve të reja;
- Bashkëpunon me kompanitë kontraktuese, në funksion të mirëmbajtjes së sistemeve, ngritjes apo zhvillimeve të funksioneve shtesë dhe testeimeve të sistemeve ekzistuese;
- Ofron trajnime për pjesëmarrësit e rinjë dhe ndihmon në përgatitjen teknike për këta pjesëmarrës;
- Angazhohet në realizimin e detyrave për punë operacionale në sistemet e pagesave dhe sistemet tjera në kuadër të fushëveprimit të Departamentit, për rastet e jashtëzakonshme dhe ofron zgjidhje teknike;
- Angazhohet në draftimin e dokumenteve (rregullore, manuale të përdorimit, udhëzime teknike, procedura, etj) për sistemet në kuadër te fushëveprimit te Departamentit;
- Angazhohet në përgatitjen e raporteve, procedurave dhe standardeve të ndërlidhura me menaxhimin e rrezikut operacional;
- Duhet të jetë i/e njoftuar dhe angazhuar me të gjitha funksionet e sistemeve qe operohen nga Departamenti.;
- Komunikon dhe koordinon aktivitetet me departamentet dhe divizionet tjera të BQK-së lidhur me kërkesat dhe nevojat që rrjedhin për mbarëvajtjen e operacioneve;
- Komunikon dhe ofron konsultat sipas nevojës për pjesëmarrësit e sistemit të pagesave, si dhe për palët e treta;
- Monitoron dhe ofron zgjidhje për funksionet teknik që lidhen me sistemet.
- Angazhohet në përcjelljen e zhvillimeve të reja në fushën e shërbimeve të pagesave në BE e më gjerë, me standardet e mesazheve financiare, si dhe në analizimin dhe propozime për avancimin e funksioneve të sistemeve të pagesave;
- Angazhohet në monitorimin e veglave të ndryshme teknike të ndërlidhura me sistemet, si dhe përgatitjen e veglave për filtrim të raporteve të njëhershme nga baza e të dhënave;
- Sipas nevojë kryen punë të tjera të lidhura me sistemet që operohen në kuadër të DSP-së, të deleguara nga mbikëqyrësi apo hierarkia më lartë apo me obligimet që rrjedhin në kuadër të përgjegjësie në DSP dhe BQK.

Përgatitjet Profesionale/Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, drejtësisë, shkencave kompjuterike, teknike, matematikës apo fushat tjera të cilat ndërlidhen me përgjegjësitë e njësisë organizative;
- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në sektorin financiar, ose përvojë në fushën që ndërlidhet me përgjegjësitë e njësisë organizative;
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë dhe njohuri në administrimin dhe mbështetjen teknike të sistemeve të pagesave ndër-bankare si dhe mesazhet financiare të përdorura në këto sisteme;
- Shkathtësi organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathtësi ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e problemeve dhe adaptim të shpejt me zhvillimet e reja;
- Saktësi, vëmendje në detaje, si dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të avancuara të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së** gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e **përgatitur posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës**, që mbulojnë së **paku dy (2) vite** përvojë pune (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, që mbulon së **paku dy (2) vite** përvojë pune, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **09 mars 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (**https://hris.bqk-kos.org**) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Naziv radnog mesta :** Službenik/ca za podršku operacijama platnih sistema  
**Stepen pozicije:** P06  
**Trajanje zaposlenja:** Na neodređeno vreme  
**Odeljenje:** Odeljenje za platni sistem  
**Odsek:** Odsek za operacije platnih sistema  
**Izveštava:** Šefa Odseka operacije sistema

Opis dužnosti i odgovornosti:

- Obavlja zadatke predviđene u okviru operativnih radnih procedura, u Platnom sistemu-KIPS, kao i drugim sistemima, u okviru delokruga Odeljenja;
- Koordinira aktivnosti sa Odeljenjem za informacione tehnologije u CBK, u slučajevima nastanka tehničkih/operativnih problema ili novih razvoja;
- Sarađuje sa ugovornim kompanijama, u cilju održavanja sistema, uspostavljanja ili razvoja dodatnih funkcija i testiranja postojećih sistema;
- Pruža obuku za nove učesnike i pomaže u tehničkoj pripremi ovih učesnika;
- Uključuje se u izvršenju zadataka za operativni rad u platnim sistemima i drugim sistemima u okviru delokruga Odeljenja, za izuzetne slučajeve i pruža tehnička rešenja;
- Uključuje se u izradu dokumenata (propisa, korisničkih priručnika, tehničkih uputstava, procedura itd.) za sisteme u okviru delokruga Odeljenja;
- Uključuje se u pripremu izveštaja, procedura i standarda vezanih za upravljanje operativnim rizicima;
- Mora biti upoznat i uključen u sve funkcije sistema kojima upravlja Odeljenje;
- Komunicira i koordinira aktivnosti sa drugim odeljenjima i odsecima CBK u vezi sa zahtevima i potrebama koje se javljaju za nesmetano funkcionisanje poslovanja;
- Komunicira i pruža konsultacije po potrebi učesnicima platnog sistema, kao i trećim licima;
- Prati i pruža rešenja za tehničke funkcije vezane za sisteme.
- Uključuje se u praćenje novih razvoja u oblasti platnih usluga u EU i šire, sa standardima finansijskih poruka, kao i analizira i predlaže predloge za unapređenje funkcija platnog sistema;
- Uključuje se u praćenje različitih tehničkih alata vezanih za sisteme, kao i pripremom alata za filtriranje jednokratnih izveštaja iz baze podataka;
- Po potrebi, obavlja i druge zadatke vezane za sisteme koji se koriste u okviru OPS-a, delegirane od strane supervizora ili više hijerarhije ili sa obavezama koje proizilaze iz okvira odgovornosti u OPS-u i CBK-u.

Stručna sprema/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, prava, računarskih nauka, tehničkih nauka, matematike ili drugih srodnih oblasti koje su povezane sa odgovornostima organizacione jedinice
- Najmanje dvije (2) godine profesionalnog radnog iskustva u finansijskom sektoru ili iskustvo u oblasti koja je povezana sa odgovornostima organizacione jedinice.
- Kandidati sa iskustvom i znanjem u administriranju i tehničkoj podršci međubankarskih platnih sistema, kao i finansijskih poruka koje se koriste u ovim sistemima, imaće prednost;
- Organizacione i veštine planiranja i upravljanja vremenom;
- Međuljudske i komunikacijske veštine, kao i sposobnost rešavanja problema i brzog prilagođavanja novim dešavanjima;
- Tačnost, pažnja prema detaljima i osetljivost na prioritete;
- Napredno poznavanje korišćenja MS Office softverskih aplikacija;
- Treba da ima tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Svi kandidati trebaju dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Prijave sa nepotpuno ili netačno popunjenim službenim formularom CBK-a tokom online apliciranja neće biti razmatrane i rezultirat će diskvalifikacijom u procesu selekcije;
- Kandidati trebaju priložiti motivaciono pismo, adresirano i posebno pripremljeno za poziciju na koju apliciraju; u suprotnom, prijava neće biti uzeta u razmatranje;
- Dokaz o radnom iskustvu u trajanju od najmanje dve (2) godine (kopije ugovora o radu, potvrde poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji potvrđuju obavljanu poziciju i radno iskustvo, bez kršenja relevantnih propisa o zaštiti ličnih podataka);
- Izveštaj Kosovskog penzionog fonda (Trusta) za relevantni period koji pokriva najmanje dve (2) godine radnog iskustva, ili – u slučajevima kada se izvještaj iz Trusta zakonski ne primjenjuje – poreska potvrda iz Poreske administracije Kosova (ATK);
- Kopije diploma; diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate / nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu / kopija lične karte koja služi kao potvrda državljanstva Kosova.

Procedura apliciranja:

- Roka za apliciranje je **09. marta 2026. godine**
- Apliciranje se može obaviti na mreži (**https://hris.bqk-kos.org**) preko službene internet stranice të CBK-a. Drugi oblici apliciranja neće se uzeti u obzir.



### SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Zyrtar/e i Ri/e për Menaxhimin e Rreziqeve Financiare  
**Niveli i gradës:** P07  
**Kohëzgjatja e punësimit:** me afat të pacaktuar  
**Departamenti:** Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut  
**Divizioni:** Divizioni i Rreziqeve Financiare  
**Raporton tek:** Udhëheqësi/e i/e Divizionit të Rreziqeve Financiare

**Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:**

- Asiston në plotësimin dhe përditësimin e kuadrit rregullativ, për menaxhimin e rrezikut financiar si dhe zbatimin e përgjegjësiqe qe dalin nga kuadri rregullativ;
- Asiston në draftimin dhe propozon ndryshime për Rregullën për Menaxhimin e Rrezikut Financiar dhe akte të tjera juridike në shërbim të kuadrit të menaxhimit të rrezikut financiar në BQK, përfshirë procedurat, udhëzimet, indikatorët dhe metodologjinë e identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve;
- Kontrollon, monitoron dhe raporton për gjendjen e ekspozimeve në rrezikun kreditor, normës së interesit dhe likuiditetit kundrejt apetitit të vendosur të rrezikut;
- Bashkëpunon ngushtë me Departamentin e Menaxhimit të Mjeteve dhe Rezervave për të analizuar rrezikun që lidhet me transaksionet dhe palët e kundërta specifike dhe ndihmon Departamentin e Menaxhimit të Mjeteve dhe Rezervave në përpilimin e planeve të veprimit për përgjigje ndaj rreziqeve;
- Asiston në kryerjen e vlerësimeve të rrezikut kreditor, likuiditetit dhe të tregut në lidhje me Rezervat e BQK-së dhe në përgatitjen e raporteve të rregullta të rrezikut për Komitetin e Investimeve dhe Bordin Ekzekutiv;
- Përgjegjës për përgatitjen e raporteve ditore, mujore, tremujore vlerësimin e rreziqeve financiare të cilave iu ekspozohet BQK-ja dhe përgatitjen e raporteve ad hoc lidhur me rreziqet financiare që ndërlihen me investimet e portfolios së BQK-së;
- Monitoron trendet e rrezikut;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

**Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:**

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, matematikës apo fushat tjera të cilat ndërlihen me përgjegjësitë e departamentit/divizionit;
- Të paktën një (1) vit përvojë pune profesionale në sektorin financiar ose në përvojë në fushën e cila ndërlihet me përgjegjësitë e njësisë organizative.
- Preferohen certifikime dhe specializimeve të ndryshme në fushën e financave apo në fushën e rrezikut financiar;
- Shkathtësi të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi;

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së** gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht **për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës**, që mbulojnë **së paku një (1) vit** përvojë pune (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, që mbulon **së paku një (1) vit** përvojë pune, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **09 mars 20226**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



### OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Pozicija:** Mladi/a službenik/ca za upravljanje finansijskim rizicima  
**Nivo platnog razreda:** P07  
**Trajanje zaposlenja:** na neodređeno vreme  
**Odeljenje:** Odeljenje za upravljanje rizikom  
**Divizija:** Divizija finansijskih rizika  
**Odgovara:** Rukovodiocu/ki Divizije finansijskih rizika

**Opis poslova i odgovornosti:**

- Pomaže u dopuni i ažuriranju regulatornog okvira za upravljanje finansijskim rizicima, kao i u sprovođenju obaveza koje proizlaze iz regulatornog okvira;
- Pomaže u izradi nacрта i predlaže izmene Pravila o upravljanju finansijskim rizikom i drugih pravnih akata u funkciji okvira upravljanja finansijskim rizikom u CBK, uključujući procedure, smernice, indikatore i metodologiju identifikacije, procene i praćenja rizika;
- Kontroliše, prati i izveštava o stanju izloženosti kreditnom riziku, riziku kamatne stope i riziku likvidnosti u odnosu na utvrđeni apetit za rizik;
- Blisko sarađuje sa Odeljenjem za upravljanje sredstvima i rezervama u analizi rizika povezanih sa transakcijama i specifičnim protivstranama, te pomaže Odeljenju za upravljanje sredstvima i rezervama u izradi akcionih planova za odgovor na rizike;
- Pomaže u sprovođenju procena kreditnog rizika, rizika likvidnosti i tržišnog rizika u vezi sa rezervama CBK, kao i u pripremi redovnih izveštaja o riziku za Investicioni komitet i Izvršni odbor;
- Odgovoran/na je za pripremu dnevnih, mesečnih i tromesečnih izveštaja o proceni finansijskih rizika kojima je CBK izložena, kao i za pripremu ad hoc izveštaja u vezi sa finansijskim rizicima povezanim sa investicijama portfolija CBK;
- Prati trendove rizika;
- Obavlja i druge poslove po nalogu nadređenog.

**Tražene kvalifikacije i iskustvo:**

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, matematike ili drugih oblasti koje su povezane sa odgovornostima odeljenja/divizije;
- Najmanje jedna (1) godina profesionalnog radnog iskustva u finansijskom sektoru ili iskustvo u oblasti povezanoj sa odgovornostima organizacione jedinice;
- Poželjne su različite sertifikacije i specijalizacije iz oblasti finansija ili finansijskih rizika;
- Dobre komunikacione i prezentacione veštine;
- Poznavanje engleskog jezika predstavlja prednost.

**Svi kandidati moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:**

- Prijave koje nisu u potpunosti i tačno popunjene u zvaničnom obrascu CBK tokom online apliciranja neće biti razmatrane i biće diskvalifikovane tokom selekcionog procesa;
- Kandidati moraju priložiti propratno (motivaciono) pismo, koje mora biti adresirano i pripremljeno posebno za poziciju za koju se prijavljuju; u suprotnom prijava neće biti razmatrana;
- Dokaz o radnom iskustvu koje pokriva najmanje jednu (1) godinu radnog iskustva (kopije ugovora o radu, potvrde poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji dokazuju obavljenu poziciju i radno iskustvo, bez narušavanja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka);
- Izveštaj iz Kosovskog penzionog štednog fonda (Trust) za relevantni period koji pokriva najmanje jednu (1) godinu radnog iskustva, ili, u slučajevima kada izveštaj iz Trust-a zakonski nije primenljiv, poreska potvrda Poreske uprave Kosova (PUK);
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nosrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu / kopija lične karte koja služi za potvrdu državljanstva Republike Kosovo.

**Procedura prijavlivanja:**

- Krajnji rok za prijavu je 09. marta 2026. godine.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) putem zvanične internet stranice CBK. Drugi oblici prijavlivanja neće biti razmatrani.



ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA  
Since 1906

Columbus, Georgia, USA  
Since 1906 0.5L

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

